



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 21 të Rregullores MF-NR.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E PASURISË JOFINANCIARE

Neni 1
Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për vlerësimin e pasurisë jofinanciare të Komunës (në vazhdim të tekstit Komisioni) në këtë përbërje:

1. Shaban Syla, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Kryesues
2. Hasan Zeqiri, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar
3. Ramadan Banulla, Drejtorati për Administratë, anëtar
4. Minavere Rexha, Drejtorati për Arsim, anëtare
5. Kushtrim Salihu, Drejtorati për Shërbime Publike, anëtar

Neni 2
Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati Komisionit

Përgjegjësitë e Komisionit janë:

1. Vlerësimi i pasurive të dëmtuara;
2. Vlerësimi i kërkesave për tjetërsim të pasurive;
3. Prezantimi i dëshmimeve për vlerësimin e pasurisë;
4. Përgatitja e raportit për pasurinë jofinanciare që duhet të largohet nga përdorimi

Komisioni do ti kryej detyrat në pajtim me e dispozitat e Rregullores MF-NR.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore .

Komisioni ka mandat të beje vlerësimin e pasurisë jofinanciare, përkohësisht më së largu me datë 31.12.2017.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 404-1910
Lipjan, më 18.01.2017

